

Kontaktet e ATK-së:

Regjioni	Numri	Adresa
DTM	0383 (0) 38 / 200 255 23	Rruga "Fehmi Agani" nr. 41
Prishtina 1	0383 (0) 38 / 200 255 87	Sheshi "Nëna Terezë", objekti i ish Gërmisë
Prishtina 2	0383 (0) 38 / 200 255 61	Sheshi "Nëna Terezë", objekti i ish Gërmisë
Prishtina 3	0383 (0) 38 / 200 255 60	Sheshi "Nëna Terezë", objekti i ish Gërmisë
Prizren	0383 (0) 29 / 625 903	Rruga "William Walker" PN
Pejë	0383 (0) 39 / 432 812	Sheshi "Skënderbeu" PN
Ferizaj	0383 (0) 290 / 320 387	Rruga "Dëshmorët e Kombit" PN
Gjilan	0383 (0) 280 / 326 967	Sheshi "Skënderbeu" PN
Mitrovicë	0383 (0) 28 / 530 059	Rruga "Agim Hajrizi" PN
Gjakovë	0383 (0) 390 / 330 021	Rruga "Nëna Terezë", PN

Këndi i rrugëve "Bill Clinton & Dëshmorët e Kombit"
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: + 383 (0) 38 200 250 17
Fax: + 383 (0) 38 200 250 07

E-mail: info@atk-ks.org
Web: www.atk-ks.org

TVSH	TAP	TAK
50%	30%	20%


Rreth **50% e të hyrave** të ATK-së vijnë nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Çka është TVSH?

TVSH, është tatim mbi konsumin (qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve). TVSH, përfshin aplikimin e tatimit të përgjithshëm në konsum për mallra dhe shërbime, që është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve.

TVSH, llogaritet në këtë çmim sipas normës së aplikueshme, ngarkohet në fazat e ndryshme të prodhimit, shpërndarjes dhe ciklit jetësor të tregtisë së mallrave dhe shërbimeve, që në fund bartet nga konsumatori final.

Secili person është i obliguar të paguaj tatimet e parapara me Ligj!



Fletëpalosje

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Fletëpalosja për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ka për qëllim Edukimin dhe Informimin e Tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre, lidhur me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo



Implemented by

giz
German Development
Cooperation Agency (GIZ)



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

Kush duhet të regjistrohet për TVSH dhe si bëhet regjistrimi?

Çdo person, i cili zhvillon aktivitet ekonomik në mënyrë të pavarur dhe tejkalon qarkullimin prej tridhjetëmijë euro (30,000€) brenda vitit kalendarik, duhet të aplikoj për t'u regjistruar për TVSH.

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike përmes ueb faqes së ATK-së www.atk-ks.org, gjegjësisht Sistemit Elektronik EDI. Pasi të parashtrohet kërkesa, sistemi do të bëjë verifikimin e të dhënave të tatimpaguesit. Nëse plotësohen të gjitha kriteret për regjistrim në TVSH, regjistrimi do të bëhet në mënyrë elektronike, në të kundërtën personi do të pranohet mesazhin për mosplotësim të kriterëve. Në momentin e regjistrimit për TVSH, personi do të pranohet mesazhin, me të cilin njoftohet se regjistrimi ka përfunduar me sukses dhe njëherësh pranohet edhe numrin e TVSH-së. Po ashtu, në mënyrë elektronike, personi njoftohet se Certifikatën e TVSH-së duhet ta tërheq në zyrën përkatëse të Shërbimit të Tatimpaguesve.

Kush mund të regjistrohet vullnetarisht për TVSH?

Personi i përfshirë në aktivitet ekonomik në mënyrë të pavarur që ka qarkullim nën pragun e përcaktuar tridhjetëmijë euro (30,000€) brenda vitit kalendarik, mund të regjistrohet si deklarues vullnetar për TVSH. Nga momenti kur ai bëhet deklarues i TVSH-së në mënyrë vullnetare, i merr të drejtat dhe përgjegjësitë si çdo deklarues tjetër i TVSH-së.

Kur mund të bëhet çregjistrimi nga TVSH?

Personi i cili është deklarues i TVSH-së, mund të kërkojë të çregjistrohet nga TVSH kur qarkullimi i tij gjatë vitit të fundit kalendarik është nën pragun e përcaktuar prej tridhjetëmijë euro (30,000€). Çregjistrimi hyn në fuqi dy (2) muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës, nëse aprovohet nga ATK.

Cilat janë normat e TVSH-së ?

- Norma standarde e TVSH-së është **18%**;
- Norma e reduktuar e TVSH-së është **8%**.

Kush është i obliguar të deklarojë për TVSH?

Secili person, i cili në mënyrë të pavarur zhvillon aktivitet ekonomik në Kosovë, dhe kur qarkullimi total brenda vitit kalendarik tejkalon pragun prej tridhjetëmijë euro (30,000€), personi që dëshiron vullnetarisht të regjistrohet në TVSH dhe personi jo-rezident në Kosovë (pavarësisht pragut), duhet të regjistrohen për TVSH, pra bëhen deklarues të TVSH-së dhe duhet të deklarojnë TVSH në baza mujore.



Kur duhet ngarkuar TVSH-në?

Çdo deklarues i TVSH-së, në furnizimet e tatueshme të bëra për konsumatorët e tij, duhet të ngarkojë TVSH. Momenti i lindjes së detyrimit për të ngarkuar TVSH është momenti kur ndodh furnizimi i mallit apo shërbimit. TVSH bëhet e ngarkueshme varësisht se cili nga tre momentet ndodh e para:

- Furnizimi i mallit apo shërbimit;
- Lëshimi i faturës në lidhje me furnizimin e mallit apo shërbimit; ose
- Pranimi i pagesës në avanc/paradhënie, para se të ketë ndodh furnizimi i mallit apo shërbimit.

Përfundim nga kjo, në rastet kur ligji përcakton rregulla të veçanta, nuk aplikohen rregullat e përgjithshme.

Çka nëse një person ngarkon TVSH, pa qenë i regjistruar për TVSH?

Nëse një person që nuk është i regjistruar për TVSH, e ngarkon TVSH-në në furnizimet e bëra, do t'i nënshtrohet obligimit të TVSH-së mbi ato furnizime, si dhe do të aplikohen ndëshkime të përcaktuara me legjislacionin tatimor.

Kur duhet të deklarohet TVSH?

Deklarimi dhe pagesa e TVSH-së, bëhet më së voni deri në datën 20 të muajit pasues për muajin paraprak. P.sh. deklarata e muajit korrik, dorëzohet më së voni deri me datën 20 gusht, të po të njëjtit vit. Në rastet kur data 20 është ditë feste apo ditë vikendi, afat i deklarimit konsiderohet dita e ardhshme e punës.

Kur lind e drejta dhe cila është mënyra për të zbritur TVSH-në?

TVSH e zbritshme lind në kohën kur TVSH bëhet e ngarkueshme. Deklaruesi i TVSH-së mund të zbres nga obligimet e tij të TVSH-së, TVSH-në e paguar në lidhje me blerjet e mallrave dhe shërbimeve. E drejta për të zbritur TVSH-në e zbritshme i'u takon të gjithë deklaruesve të TVSH-së, të cilët ato blerje i përdorin apo synojnë t'i përdorin për furnizime të tatueshme dhe furnizime të liruara me të drejtën e zbritjes së TVSH-së së zbritshme.

Deri kur mund të shfrytëzohet e drejta për të njohur TVSH-në e zbritshme?

Nëse deklaruesi i TVSH-së nuk e zbrit TVSH-në e zbritshme në periudhën tatimore përkatëse, ai mund ta zbres këtë shumë të TVSH-së së zbritshme në çdo kohë pas kësaj periudhe tatimore, mirëpo, jo më vonë se në periudhën e fundit tatimore të vitit kalendarik, që vijon pas vitit në të cilin ai e ka pasur të drejtën që të zbres TVSH-në e zbritshme.

Kush është përgjegjës për pagesën e TVSH-së?

- Deklaruesi i TVSH-së që ofron furnizim të tatueshëm të mallrave ose shërbimeve, me përjashtim kur ligji përcakton se TVSH duhet të paguhet nga personi tjetër;
- Personi i cili është i regjistruar për qëllime të TVSH-së në Kosovë, të cilit i janë furnizuar mallrat dhe shërbimet nga personi i tatueshëm që nuk është i themeluar në Kosovë, nëse vendi i furnizimit konsiderohet të jetë Kosova;
- Personi i cili prezanton TVSH-në në një faturë;
- Personi përgjegjës për pagesën e detyrimeve doganore në import, siç përcaktohet me legjislacionin doganor në fuqi;
- Personi i cili bën që mallrat të pushojnë së përfshiri në depot doganore, depot tjera dhe aranzhimet e ngjashme;
- Përfaqësuesi tatimor si person i obliguar për të paguar TVSH-në në emër të personit të tatueshëm, i cili nuk është i themeluar në Kosovë.

Cilat janë procedurat për rimbursim të TVSH-së?

Për të kërkuar rimbursim të TVSH-së, duhet të plotësohen kriteret si në vijim:

- Të jeni në balancë kreditore për tre muaj radhazi;
- Në fund të muajit të tretë shuma e kreditimit të TVSH-së, duhet të tejkalojë vlerën e përcaktuar me ligj;
- Përveç kësaj rregulle personi që ka eksporte, mund të kërkojë rimbursimin e TVSH-së pas secilës periudhë tatimore;
- Të keni të deklaruar të gjitha deklaratat e TVSH-së, si dhe llojeve të tjera të tatimeve për të gjitha periudhat e kaluara. Për eksporte duhet të përmbushen edhe të gjitha dispozitat e aplikueshme doganore;
- Përveç procedurave të lartshënuara, kërkesa për rimbursim në periudha mujore mund të parashtrohet edhe nga kontraktuesi i Komisionit Evropian, pavarësisht shumës së kreditimit;
- Limiti i përcaktuar me ligj nuk vlen për personin i cili ndërprente aktivitetin e tij ekonomik.

